ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **00220-24-1597-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material medicinal nga LE për nevojat e SHSKUK-së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**VECTOR CLEAN SH.P.K.**
NUI	**811913616**
Adresa	**Rr Motrat Qiriazi**
Vendi	**Prishtine**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**vector clean**
Adresa elektronike	**infovectorclean@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**23.04.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Lot-1[]Lot-2[]Lot-3

Me 28.02.2024, "SHSKUK - Shërbimi Spitalor Klinik Universitare I Kosovës" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me material medicinal nga LE për nevojat e SHSKUK-së" me nr. të prokurimit: 00220-24-1597-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: Lot 1: 3,431,867.00€ ,Lot 2: 3,798,425.00€ Lot 3: 21,814.91€

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Më datë 27.02.2024 AK SHSKUK ka publikuar njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material medicinal nga-l.E për nevojat e SHSKUK-së" me numër të prokurimit 00220-24-1597-1-1-1 dhe 220-24-026-111. Kundër këtij njoftimi për kontratë, ne si OE parashtrojme kërkesë për rishqyrtim në AK SHSKUK me pretendimet tona.

Autoriteti Kontraktues me dokumentet e kerkuara ne dosjen e tenderit dhe Njoftimin per Kontrate ka përcaktuar disa kritere diskriminuese dhe kufizuese të

cilat krijojnë pozitë jo të barabartë të Operatorëve

Ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit, kufizojnë mundësinë e tyre për të tenderuar në mënyrë të padrejtë dhe vështirësojnë në mënyrë të jashtëzakonshme mundësinë për të ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1, 6, 7, 11, 61, 69, 72, si dhe Rregullorja RROUP 01/2022

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Më datë 27.02.2024 AK SHSKUK ka publikuar njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e
prokurimit me titull "Furnizim me material medicinal nga-l.E për nevojat e SHSKUK-së" me numër të prokurimit 00220-24-1597-1-1-1 dhe 220-24-026-111.
Kundër këtij njoftimi për kontratë, ne si OE parashtrojme kërkesë për rishqyrtim në AK SHSKUK me pretendimet tona.
Autoriteti Kontraktues me dokumentet e kerkuara ne dosjen e tenderit dhe Njoftimin per Kontrate ka përcaktuar disa kritere diskriminuese dhe kufizuese të cilat krijojnë pozitë jo të barabartë të Operatorëve Ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit, kufizojnë mundësinë e tyre për të tenderuar në mënyrë të padrejtë dhe vështirësojnë në mënyrë të jashtëzakonshme mundësinë për të
ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit. Ne si operator ekonomik nuk pajtohemi me kriterin e vendosur nga AK SHSKUK në
pikën 8.1 & 8.2 "Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare" - Kapaciteti ekonomik dhe financiar, ku është përcakiuar kërkesa 1, si në vijim: "Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet ti ofrijë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontratë është jo më pak se Lot 1 - 6,000,000.00 Euro , Lot 2
- 6,000,000.00 Euro dhe Lot 3 - 30,000.00 Euro. Lideri i Grupit të Operatorëve ekonomik duhet të ketë 51% e qarkullimit financiar sipas UDHËZUESIT Nr.001 2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK."
2. Ndërsa si dëshmi të kërkuar dokumentare është kërkuar, si në vijim:

“Evidenca 1. Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.”

3. Më tutje, AK SHSKUK në dosjen e tenderit te pjesa Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2, kërkesa nr. 5, që kërkuar: **3**“Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi një listë te kontratave te natyrës se ngjashme te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellur me referenca apo raporte te pranimit 1.5 herë ne vlerë te lotit apo loteve që oferton.”
4. Ndërsa si dëshmi dokumentare te evidenca ka kërkuar:
“Evidenca 5. Operatori Ekonomik ofertues duhët të ofrojë dëshmi një listë te ; kontratave te natyrës se ngjashme te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellur me referenca apo i raporte te pranimit 1.5 here
ne vlerë te lotit (vlerës së parashikuar), ose loteve qe oferton. Në rast të grupit te Operatorëve Ekonomik (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 51% të shumës së kërkuar. Lista e kontratave duhet te përmbaje -Autoritetm Kontraktues Blerësm. -Titullin e Kontratës, -Vlerën e Kontratës, -Datën e nënshkrimit te kontratës, -Datën e përfundimit te kontratës.
Kur furnizimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të kryerjes së .< furnizimeve shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë (trasaksioni bankar)

Ne e konsiderojme se këto kërkesa/kritere të dosjes së tenderit janë diskriminuese në kuptim të nenit 7 të LPP-së, për a.syet si në vijim.
6. Siç shihet, Autoriteti Kontraktues kërkon dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës si kriter i qarkullimit vjetor të cilin cfuhet ta përmbushin operatorët ekonomik për të ofertuar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Kjo është në kundërshtim me vet kontratën dhe vlerën e përcaktuar të kontratës dhe këtë kriter nuk mund ta plotësoj pothuajse asnjë operator ekonomik. 7. Sipas praktikës së vet AK SHSKUK, në dosjen e një tenderi tjetër, respektivisht në dosjen e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material
për Hemodializë nga LE për SHSKUK” në aktiviteti e prokurimit me numër 00220- 23- 12480-1-1-1, si kërkesa për kapacitetin ekonomik dhe financiar është kërkuar vetëm referenca për përmbushjen e kënaqshme të kontratave paraprake dhe nuk janë kërkuar as
vlera të kontratave e as referenca për qarkullimin vjetor.

8. Këto kritere siç janë përcaktuar nga ana e AK SHSKUK me këtë dosje të tenderit që po e kundërshtojmë e kufizojnë jashtë mase konkurrencën në këtë aktivitet të prokurimit dhe një kërkesë e tillë për të dorëzuar dëshmi për qarkullim vjetor për më shumë se 6,000,000.00 Euro dhe dtë dorëzoj dëshmi të kontratave të ngjashme të realizuara në vlerë prej 1.5 herë të vlerës së lotit apo lotëve që oferton, janë në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, ku përcaktohet se:

“2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. 3. Pa e cenuarparagrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë
nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë te prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose disk/imjnojë kundër njërit ose me shumë operatorëve ekonomik. 6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhespecifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (jv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje,-dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat epërzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës
të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin epërzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe spcifikimeve përkatëse.”

9. AK SHSKUK është dashur të respektoj detyrimet që dalin nga neni 7 i LPP-së, dhe në vend të qarkullimit vjetor prej 6,000,000^00 Euro si kërkesë të kapacitete ekonomike dhe në vend të kërkesës për të copëzuar dëshmi të një liste të kontratave të natyrë së ngjashme në tri vitet e shkuara të përcjellura me referenca apo raporte të pranimit 1.5 herë në vlerë të lotit apo
lotëve që oferton, duhet të përcaktoj si kriter vetëm kërkesën për referencat për kontratat e përmbushura kënaqshëm në tri vitet e fundit por pa vlerë të kontratës.
10. Kjo do të mundësoj pjesëmarrje sa më të gjerë të mundshme të operatorëve ekonomik të interesuar dhe eliminimin e praktikave, kritereve dhe kërkesave të cilat diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik. 11.EIiminimi i këtij kriteri do të mundësonte po ashtu që sa më shumë operator ekonomik të dorëzojnë ofertën e tyre dhe rrjedhimisht të ofertojnë me çmime sa më të lira dhe kjo do të mundësonte edhe kursimin e buxhetit të Republikës së Kosovës.
12. Në anën tjetër, kriteri i përcaktuar nga ana e AK SHSKUK që dëshmia për kapacitetin ekonomik të jetë mbi 6,000,000.00 Euro dhe kërkesa për të dorëzuar dëshmi të një liste të kontratave të natyrë së ngjashme në tri vitet e shkuara të përcjellura me referenca apo raporte të pranimit 1.5 herë në vlerë të lotit apo lotëve që oferton, kufizon konkurrencën, mundëson
që të favorizohet vetëm një operator ekonomik në dëm të operatorëve tjerë ekonomike, kufizon mundësin që Autoriteti Kontraktues të ketë në dispozicion më shumë oferta dhe të zgjedh më të lirën dhe kështu të kursej buxhetin e Kosovës, kufizon mundësinë që Autoriteti

Kontraktues të ketë në dispozicion më shumë oferta dhe rrjedhimisht të zgjedh produkte sa më cilësore, dhe rrjedhimisht i mundësohet vetëm një operatori ekonomik me çmime shumë të shtrenjta dhe ndoshta më produkte jo cilësore të jetë i suksesshëm në këtë aktivitet të prokurimit dhe kjo ndodhë pikërisht për faktin se me këtë kriter do të ketë shumë pak oferta të dorëzuara.

13. Më tutje, ne kemi kërkuar që AK të rishikoj edhe afatin për dorëzimin e ofertave, sepse afati është përcaktuar të jetë deri më 15.03.2024. Rrjedhimisht, AK SHSKUK ka lënë afat për dorëzim të ofertave rreth 15 ditë për një aktivitet të . prokurimit 3 vjeçare me vlera të kontratës prej mbi 3 milion euro për një lot apo ; në total për një aktivitet me vlerë mbi 7 milion.
Andaj,kjo vështirëson po ashtu mundësinë që operatorët ekonomik të përgatisin ofertat e tyre për një kohë kaq të shkurtër prej 15 ditësh. Konsiderojmë se kjo është në kundërshtim edhe me vet praktikën e AK SHSKUK, ku psh për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material për Hemodializë nga LE për SHSKUK" në aktivitetin e prokurimit me numër 00220-23-12480-1-1-1, është paraparë një afat për dorëzimin e ofertave për më shumë se 30 ditë.
14. Andaj, kemi rekomanduar që AK SHSKUK të ndryshoj datën për dorëzimin e tenderit dhe ta zgjasë atë për një periudhë prej 60 ditë nga data e publikimit të ; kontratës. Këtë kërkesë e mbështesim për faktin se afati prej 15 ditësh për dorëzim të tenderit mundëson që të favorizohet vetëm një operator ekonomik në ; dëm të operatorëve tjerë ekonomike, kufizon mundësinë që Autoriteti Kontraktues të ketë në dispozicion më shumë oferta dhe të zgjedh më të lirën dhe kështu të kursej buxhetin e Kosovës, kufizon mundësinë që Autoriteti Kontraktues të ketë në dispozicion më shumë oferta dhe rrjedhimisht të zgjedh produkte sa më cilësore, dhe rrjedhimisht i mundësohet vetëm një operatori ekonomik me çmime shumë të shtrenjta dhe ndoshta më produkte jo cilësore të jetë i suksesshëm në ; këtë aktivitet të prokurimit dhe kjo ndodhë pikërisht për faktin se me këtë kriter do të ketë shumë pak oferta të dorëzuara.

15. Rrjedhimisht, edhe ky kriter qe tenderi të dorëzohet në afat prej 15 ditësh
përbën diskriminim në kuptim të nenit 7 të LPP-së, për arsyet tashmë të theksuara.
16. Të gjitha këto pretendime as që janë shqyrtuar nga ana e AK SHSKUK, sepse e njëjta me një arsyetim të përgjithshëm thekson se kinse këto kritere janë përcaktuar në përputhje me nenet 60, 68, 69, të LPP-së dhe vetëm i ka cituar këto dispozita ligjore. Pra, e njëjta fare nuk argumenton pse këto pretendime nuk I qëndrojnë dhe për mendimin tonë këtë nuk e bën
sepse AK SHSKUK është e vetëdijshme se këto kritere janë diskriminuese.
17. Shpresojmë që tani OSHP t'i trajtoj këto pretendime ankimore sepse me të njëjtat nuk pajtohen as Operatorët e tjerë ekonomik dhe kjo vërtetohet nga pyetjet sqaruese që i kanë bërë Operatorët Ekonomik ku shumica prej tyre kanë kërkuar i zgjatje të afatit për dorëzimin e ofertave sepse afati prej rreth 15 ditë për përgatitje dhe për dorëzim të

ofertave
është diskriminues. Se ky afat është diskrimmues mjafton të merret parasysh fakti se Autoriteti Kontraktues ka një afat prej 30 ditësh për t'i shqyrtuar ofertat e dorëzuara, ndërsa kërkon nga OE t'i përgatisin dhe t'i dorëzojnë ofertat e tyre në një afat prej 15 ditësh. Si është e ; mundur
që afati i AK për shqyrtim të ofertave të dorëzuara të jetë më i gjatë sesa afati për përgatitjen dhe dorëzim e ofertave nga ana e operatorëve ekonomik??? Kjo pra është jashtë çdo logjike.

Prandaj në kuptim të nenit 7 të LPP dhe të gjithë paragrafëve tjerë të kësaj dispozite, autoritetet kontraktuese janë të obliguara të veprojnë dhe ti trajtojnë të gjithë OE në mënyrë të barabartë, duke mos vendosur kërkesa të cila diskriminojnë apo favorizojnë të tjerët, e posaçërisht duhet të citohet paragrafi 6 i këtij neni, i cili citon:
"Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do tësigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin
dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose
kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të
përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse".
Kërkojme nga Autoriteti Kontraktues te miratoj kerkesen tone per Rishqyrtim, te anuloj njoftimin per hapje, te ndryshoj dhe te vazhdoj pas permisimeve tutje

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te shumta !!!!!

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*